

DËFRIM GASHI

**KRIZA E KRIMESË DHE POLITIKA
BALLKANIKE E AUSTRISË
(1850-1900)**

Problemi më i ndërlikuar në kohën e Meternikut ishte se a do të mund të frenonte Rusinë të mos ndërhynte në Ballkan. Çështja Lindore nuk do të eliminohej. Në thelb ajo ishte rezultat i luftërave për pavarësi në Ballkan, kur popullsitë e ndryshme përpqeshin të shkëputeshin nga sundimi osman. Kjo e vinte në mëdyshje sistemin e Meternikut, sepse binte ndesh me angazhimin për ruajtjen e *status quo*-së, sepse lëvizjet për pavarësi që sot drejtoheshin kundër Perandorisë Osmane, nesër do të godisnin Austrinë. Lufta e Krimesë ishte një konflikt ndërmjet Ruisë dhe Perandorisë Osmane, e cila u mbështet nga Britania dhe Franca dhe së fundi u mbështet edhe nga shteti Piomont* – Sardenjës i Italisë së Veriut.¹ Pas një varg fitoresh fillestare të Ruisë në frontin e Danubit e në det, operacionet e aleatëve të Perandorisë Osmane u përqendruan në Gadishullin e Krimesë dhe prandaj konflikti mori emrin Lufta e Krimesë.² Për një kohë, interesi i përbashkët për zbutjen e tronditjes nga përmbyjsja e Perandorisë Osmane bëri të ruheshin marrëdhëniet e mira me Britaninë e Madhe dhe Austrinë. Sadopak që Britanisë i interesonin problemet e veçanta të Ruisë, Ballkanit, përparimi drejt Ngushticave u mor si një kërcënim ndaj interesave britanike në Mesdhe dhe ndeshi në një rezistencë të ashpër. Në politikën e jashtme Austro-Hungaria u riorientua drejt ekspansionit të saj në Ballkan³.

Meterniku asnjëherë nuk mori pjesë drejtpërdrejt në këtë përpjekje të britanikeve për të kundërshtuar ekspansionizmin rus, megjithëse e dëshironte aq shumë. Diplomacia e tij e kujdesshme dhe para së gjithash

* *Piomonti* - Lidërshipi i Sardenjës, Italisë (d.m.th. Piomont Sardenja) ka ushtarë dhe topa, “prandaj unë jam një piomontez”. Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë: Leart, 1999, f. 126.

¹ Norman Rich, *Diplomacia e Fuqive të Mëdha (1814-1914)*, Tiranë: Toena, f. 39.

² Gazmend Rizaj, *Shqipëria e Sipërme (1800-1913)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë: 2011, f. 107.

³ *Enciklopedia e Jugosllavisë*, botimi në gjuhën shqipe, 1, A-Bib, Miroslav Kerlezha, Zagreb: 1984, f. 406.

anonime, afirmimi i unitetit të Evropës, lajka rusëve dhe ledhatime anglezëve, i dhanë mundësi Austrisë të ruante alternativën e Rusisë, ndërsa shtetet e tjera mbajtën peshën për të penguar ekspansionin rus. Pansllavistët rusë në kohën kur shpërtheu Lufta e Krimesë, ndërmjet Rusisë dhe Perandorisë Osmane (1853-1856) shpresuan se erdhi dita e formimit të Perandorisë së Madhe sllave⁴. Meterniku e luajti mirë kartën e Çështjes Lindore, por pasardhësit e tij, qenë të paafte për t'ia përshtatur kohës. Institucionet e brendshme të Austrisë u përpoqën të kompensonin duke e futur diplomacinë austriake në rrugën e diplomacisë së forcës që po lindte, pa u bërë merak për nocionet e ligjshmërisë. Kjo do të ishte prishja e rendit ndërkombëtar. Puna erdhi që Koncerti i Evropës u shpartallua në kudhrën e Çështjes Lindore⁵.

Shembja e sistemit të Meternikut, në prag të Luftës së Krimesë, shkaktoi konflikte gati dykatëshe: luftën e Piemontit dhe Francës kundër Austrisë më 1859, luftën për Schlesëig-Holstein më 1864, luftën austriako-pruse më 1866 dhe luftën franko-pruse më 1870. Nga këto trazira lindi një ekuilibër i ri forcash në Evropë. Franca, që mori pjesë në tri nga këto luftëra dhe nxiti të tjerat, humbi pozitën e saj të epërsisë ndaj Gjermanisë, dhe më e rëndësishmja ishte zhdukja e kufizimeve morale të sistemit të Meternikut. Simboli i kësaj përmbysjeje u bë përdorimi i termit të ri të politikës së ekuilibrit të pakufizuar të forcës, duke mbështetur politikën e tyre në *Realpolitik*- nocioni se marrëdhëniet midis shteteve përcaktohen, thjesht, nga forca dhe se fiton më i fuqishmi. Fjala gjermane “Realpolitike” zëvendësoi termin francez, “*Raison D’etat*”, por pa ndryshuar kuptimin e tij.⁶

Interesi i Fuqive të Mëdha për territoret ballkanike bëri që procesin i krijimit të kombeve dhe shoqërive moderne në Ballkan, të rihapte gjatë shek. XIX të ashtuquajturën “Çështje të Madhe Lindore”, që në thelb kishte kuptimin e çështjes së ekzistencës dhe trashëgimisë së Perandorisë Osmane në Gadishullin Ballkanik dhe në Levant. Dy Perandoritë fqinje dhe rivale, Perandoria Ruse dhe Perandoria Habsburge Austriake, rihapën Çështjen Lindore, por kësaj i ndihmoi akoma më shumë dobësimi i përgjithshëm i vetë Perandorisë Osmane, që u dëshmuua në luftërat e pasuksesshme kundër Fuqive të Mëdha evropiane në fund të shek. XVIII.

⁴ Skënder Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)*, Prizren: Drita, 1998, f. 40.

⁵ Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë: Leart, 1999, f. 92.

⁶ *Po aty*, f. 103.

Fuqitë e Mëdha, të cilat zhvillonin politikë aktive në Lindje, e kishin më lehtë të merreshin vesh për ruajtjen e Perandorisë Osmane, sesa për ndarjen e saj. Franca dhe Anglia, për shkak të interesave të tyre tregtare dhe investimit të kapitalit financiar në Perandorinë Osmane u angazhuan për politikën e *status quo*-së, sepse sulltani u kishte ofruar privilegje të mëdha tregtare. Ndërkohë, Rusia dhe Austria nisën të hartonin projekte për ndarjen e sferave të interesit në Ballkan, duke u marrë seriozisht edhe me planin e copëtimit të plotë të Perandorisë Osmane⁷.

Ndërmjet Perandorisë Ruse dhe Perandorisë Habsburge, qysh në dekadat e fundit të shek. XVIII, u shqyrtuan disa plane sekrete të ndarjes së trashëgimisë së territoreve të Perandorisë Osmane. Pansllavizmi nuk po luftonte për pavarësi kombëtare (...) qëllimi i tij ishte që, t'i fshinte nga harta Hungarinë, Perandorinë Osmane dhe Gjermaninë.⁸ Njëri prej planeve, parashihte që në rast të thyerjes së plotë të osmanëve posedimet e tyre në Ballkan të ndaheshin përpjesëtimisht ndërmjet Rosisë dhe Austrisë. Ndërkaq një tjetër plan parashikonte ndarjen e pjesshme dhe krijimin e protektorateve. Kështu, në rast të ndarjes së plotë të Perandorisë Osmane, Austrisë do t'i takonin: Serbia, Bosnja, Hercegovina, Shqipëria dhe Maqedonia, deri në More (Peleponez), ndërkaq, pjesa tjetër e Ballkanit bashkë me Stambollin e Dardanelet do t'i takonte Rosisë. Varianti i dytë i jepte Austrisë: Vllahinë, Serbinë, Bosnjën e Hercegovinën, ndërsa Rosisë pjesë të tjera të Ballkanit, në anën e majtë të Danubit dhe në Detin e Zi, me përjashtim të Krimesë, e cila mund të fitonte pavarësinë nën protektoratin rus. Ndërsa, nga Maqedonia, Shqipëria, Bullgaria, një pjesë e Arkipelagut dhe brigjeve detare të Azisë së Vogël do të krijohesh një mbretëri e veçantë me kryeqytet Stambollin dhe me të drejtën e investiturës ruse. Moreja do të organizohej si shtet i pavarur me një princ austriak, ose do t'i jepej Republikës së Venedikut, me kusht që kjo republikë ta kompensonte Austrinë me lëshimin e Istriës dhe bashkëngjitjes së saj në aleancën antiosmane. Një variant më modest i marrëveshjeve austro-ruse parashihte që osmanët të mbanin anën e majtë të Danubit dhe Austrisë t'i

⁷ G. Rizaj, *Shqipëria e Sipërme (1800-1913)*..., f. 84.

⁸ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 40.

jepnin Serbinë, Bosnjën e Hercegovinën, ndërsa Ruisë tokat e pushtuara në Detin e Zi, kurse Krimesë t'i njihej pavarësia⁹.

Me gjithë etjen e pashuar të dy perandorive për prenë e shumëdëshiruar, pavarësisht nga synimet politike të secilës prej tyre drejt Danubit, ai plan mbeti pothuajse i pandryshuar. Kurse marrëveshja austro-ruse e vitit 1897, e rikonfirmuar më 1902 nuk ishte gjë tjetër veçse forma moderne e planit të famshëm grek, ose peng i marrëveshjes së detyruar midis Austrisë dhe Ruisë, në lidhje me ndarjen e Gadishullit Ballkanik, me pretekstin makiavelist të mbrojtjes së të krishterëve¹⁰. Mirëpo, Rusia ndoqi taktikën tjetër: në vend të idesë së krishterimit, vuri në pah atë të pansllavizmit, duke i përfshirë me këtë plan-ide të gjithë sllavët e Ballkanit.¹¹

Nga fillimi i shek. XIX, si rezultat i degradimit të pandalshëm të shtetit osman si në politikën e jashtme dhe të brendshme, Fuqitë e Mëdha filluan seriozisht të merreshin me përpilimin e projekteve për ndarjen e ardhshme të Evropës Juglindore. Në këtë kontekst, projekti i Tilzitet ishte projekti i parë serioz i hartuar nga Fuqitë e Mëdha për copëtimin e Turqisë Evropiane. Kështu, pas paqes së Tilzitet (korrik 1807), Napoloni I dhe Cari i Ruisë Aleksandri I lidhën aleancë sekrete ndërmjet dy perandorive, e njohur ndryshe edhe si Projekti i Tilzitet. Lidhur me Gadishullin Ballkanik u ndanë sferat e interesit, që Rumania (Vllahia e Moldavia) dhe Bullgaria do t'i takonin Ruisë, Bosnja e Serbia do t'i takonin Austrisë, ndërkaq Shqipëria me Morenë (Gadishulli i Peleponesit) dhe Arkipelagu (deti Egje me ishuj) do t'i takonin Francës¹².

Më 1854, Fuqitë e Mëdha u ndodhën në luftë për herë të parë që nga ditët e Napolonit. Austriakët ishin të interesuar që kjo luftë të mbyllej sa më shpejt, sepse ato mund të viheshin përballë rreziqeve serioze se cilës palë do t'i bashkoheshin apo edhe po të mbeteshin asnjans.

Nëse bëheshin palë me Rusinë, ato do të çanin balancën e fuqive në lindje dhe do të zvogëlohej statusi i një sateliti rus, i varur nën mbështetjen ruse kundër armiqësisë së Britanisë dhe Francës, të cilat mund të kërkonin të minonin nga brenda pozicionin e tyre në Gjermani e

⁹ Bedrush Shehu, *Çështje shqiptare në vitet e tridhjeta të shekullit XIX*, Prishtinë: 1990, f. 16.

¹⁰ Antonio Baldaci, *Shqipëria e Madhe*, Tiranë: Eugen, 2006, f. 51-52.

¹¹ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit...*, f. 39.

¹² J. S. Stuart-Glennie, *Europe and Asia: Discussion of the Question*, London: Chapman Hall, 1879, f. 189-190; G. Rizaj, *Shqipëria e Sipërme (1800-1913)...*, f. 85.

Itali, ku ato ishin veçanërisht të cenueshme. Nëse ato merrnin anën e Britanisë dhe Francës, do të ishin të detyruara të mbanin peshën kryesore të luftimeve, për shkak të pozicionit të tyre gjeografik. Edhe po të dilnin fitimtare, ato do të ishin të detyruara të qëndronin roje vazhdimisht kundër një fqinji hakmarrës. Nëse ato do të bëheshin neutrale, atëherë do t'u ekspozoheshin kërcënimeve dhe armiqësisë të të dyja palëve. Ashtu siç edhe e përshkoi politikën e jashtme austriake, sekretari i punëve të brendshme të këtij vendi konti Buol: “ne jemi duke u përpjekur të pajtojmë të gjitha palët dhe mbi të gjitha të shmangim një ndërlikim evropian, i cili do të ishte veçanërisht i dëmshëm për ne”¹³.

Bisedimet që u zhvilluan në atë kohë në emër të paqes ishin jashtëzakonisht komplekse. Të gjitha propozimet që përfaqësonin një përpjekje të singertë për të ndërmjetësuar midis Ruisë dhe Turqisë, bazoheshin në një taktikë, në një thelb të njëjtë: që Fuqitë e Mëdha neutrale, si Austria, Britania, Franca dhe Prusia duhet të angazhonin përpjekjet e tyre të përbashkëta për t'i bindur rusët dhe qeveritarët otomanë të binin dakord për një shkëmbim notash, gjë që nuk kishin arritur ta bënin. Pas këtyre përpjekjeve qëndronte besimi se as Rusia, as Perandoria Osmane nuk do të rrezikonin të hidhnin poshtë propozime të paraqitura nga një ose nga të gjitha Fuqitë e Mëdha evropiane asnjëherë.

Me gjithë kundërshtimin e Fuqive të Mëdha ndaj luftës, Perandoria Ruse nuk hiqte dorë nga jetësimi i planeve të saj, duke mos kursyer asnjë mjet. Që të ishte më efektive ajo formoi rrjetet nëntokësore pansllaviste, të cilat u paraqitën për kryengritje¹⁴, duke i vënë kundërshtarët e vet para aktit të kryer. Pa përgatitjen e duhur, në qershor të vitit 1853, Perandoria Ruse hyri në luftë kundër Perandorisë Osmane. Ushtria ruse pushtoi Vllahinë dhe Moldavinë* dhe fundosi flotën osmane në Gjirin e Sinopes. Sikundër britanikët dhe francezët, edhe austriakët donin të ndalonin zgjerimin e ndikimit rus në Ballkan, por kuptuan se kjo mund të arrihej nëse Rusia tërhiqej nga Principatat. Austriakët nuk e kërkuan një gjë të tillë nëpërmjet bisedimeve, por i paraqitën Ruisë një ultimatum më 3 qershor 1854, duke kërkuar që kjo e fundit të ndalte veprimet luftarake në

¹³ N. Rich, *Diplomacia e Fuqive të Mëdha (1814-1914)*..., f. 110.

¹⁴ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit* ..., f. 41.

* Principata e Moldavisë dhe Vllahisë, janë Rumania e sotme, H. Kissinger, *Diplomacia*..., f. 93.

jug të Danubit dhe të fiksonte sa më parë një datë për t'u larguar nga Principatat¹⁵.

Ultimatumi austriak që një goditje për Perandorinë e Rusisë sepse, deri në këtë moment, ai kishte besuar në qëndrimin asnjans të Austrisë, megjithëse nuk kishte shpresa për të siguruar ndihmën aktive të saj. Ky ultimatum ishte gjithashtu një pikë kthese kritike në diplomacinë evropiane, sepse shënonte fundin e miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet dy Fuqive konservatore, të cilat, megjithëse do të hynin në marrëveshje madje edhe në aleanca me njëra-tjetrën në vitet e mëvonshme, asnjëherë nuk e rivendosën plotësisht miqësinë¹⁶.

Fuqitë e Mëdha evropiane: Anglia, Franca dhe Austria (të cilave iu bashkua edhe Sardenja) reagueshan shpejt. Luftimet u zhvilluan në Krime, në vitin 1855, ku ushtria Ruse pësoi disfatë të thellë. Marrëveshjet për paqe nisën dhe përfunduan në vitin 1856 në Paris. Me paqen e Parisit, Rusia u detyrua t'i anulojë pretendimet mbi Stambollin dhe Ngushticat, duke humbur kështu edhe të drejtën e ndërtimit të fortifikatave në brigjet e Detit të Zi. Ajo humbi po ashtu Besarabinë dhe kufiri i saj u shty përtej grykës së Danubit¹⁷.

Qysh nga fillimi i luftës, ashtu dhe gjatë gjithë periudhës së krizave që i kishin paraprirë asaj, austriakët mbetën të shqetësuar ndaj rrezikut që shfaqën konfliktet për Perandorinë Habsburgase. Diplomacia e aleatëve të kohës së luftës vetëm sa e rriti alarmin e tyre. Ata panë në aleancën anglo-franceze me Sardenjën një kërcënim të rrezikshëm për pozitën e tyre në Itali. Edhe më ogurzeza ishin përpjekjet e Kryeministrit Britanik Palmerston për të nxitur rebelimin ndërmjet kombësive jo ruse të Perandorisë Ruse, një politikë e cila, sikundër programi i Napolonit për të njohur sistemin e shteteve evropiane mbi bazën e nacionaliteteve, përfaqësonte një rrezik vdekjeprurës për vetë ekzistencën e Mbretërisë shumëkombëshe Habsburgase. Prandaj nuk është e habitshme që austriakët luajtën një rol udhëheqës në nxitjen e bisedimeve të paqes, në mënyrë që të dilnin nga pozita e tyre e rrezikshme.

Pas përpjekjeve të gjata të austriakëve dhe francezëve, që tashmë kërkonin paqe, aleatët lidhën marrëveshjen për kushtet e paqes dhe në dhjetor të vitit 1855 austriakët i paraqitën ultimatumin Rusisë. Rusët u

¹⁵ N. Rich, *Diplomacia e Fuqive të Mëdha (1814-1914)*..., f.110-114.

¹⁶ *Po aty*.

¹⁷ G. Rizaj, *Shqipëria e Sipërme (1800-1913)*..., f. 95.

dorëzuan pa kushte më 16 janar. Britanikët shpresonin ende të parashtronin kushte shtesë që do të rezultonin të papranueshme nga rusët. Por manovrat e tyre për të sabotuar bisedimet në Konferencën e Parisit dështuan, sepse politikat e tyre nuk gëzonin mbështetje nga ndonjë palë. Traktati i Parisit, sollti përfundimin e Luftës në Krime, më 30 mars 1856¹⁸. Në kongresin e paqes u përfaqësuan të gjitha fuqitë ndërluftuese (Britania, Franca Perandoria Osmane, Rusia, Sardenja) dhe Austria. Ky traktat përfundimtar i Parisit konfirmoi dhe qartësoi, por në thelb nuk i ndryshoi, marrëveshjet e mëparshme të arritura ndërmjet fuqive si bazë për paqen¹⁹. Siç ndodh zakonisht në konferencat ndërkombëtare, marrëveshjet dhe kompromiset më domethënëse u arritën nëpërmjet negociatorëve kryesorë -përfaqësuesve fuqiplotë të Austrisë, Britanisë dhe Francës, të cilët, në fakt, do të vendosnin ndërmjet tyre të gjitha çështjet kryesore. Suksesi i Luftës së Krimesë dhe energjia e tanzimatistëve dhanë së bashku dy rezultate të papritura - akumulimin e borxhit osman dhe riorganizimin e sistemit të miletit²⁰.

Në përputhje me kushtet e Traktatit të Parisit, ndër të tjera, principatat Danubiane të Moravisë dhe Vllahisë u vunë nën mbrojtjen e fuqive nënshkruese, të cilat më tej premtuan të respektonin integritetin dhe pavarësinë e Perandorisë Osmane. Fuqitë e Mëdha u përballën me problemin se me çfarë regjimi duhej zëvendësuar protektorati rus dhe Statutet Organike. Në diskutimet mbi këto çështje, Fuqitë ndiqnin interesat e tyre tradicionale në këtë zonë. Napoloni III, Prusia dhe Piemonti ishin për një program të plotë unionist të bashkimit të principatave nën një princ të huaj. Po kështu një program i tillë mbështetej edhe nga Rusia, e cila ishte bashkuar me Francën duke bashkëpunuar për një kohë të shkurtër në çështjet ndërkombëtare. Kundër tyre ishte Porta e Lartë, që e shihte bashkimin si një shkelje të të drejtave të saj dhe një hap që, në mënyrë të pashmangshme, do të shpinte në pavarësi. Tani e tutje, edhe qeveria habsburge mbështeste qëndrimin osman. Po kështu edhe Britania ishte kundër bashkimit, sepse ajo preferonte të ruhej një Perandori Osmane e fortë.

Autori Misha Gleny pohon se principatat me të vërtetë u gjetën në një zbrazëti pushteti të veçantë, ku shumica e bujarëve, ndër ta edhe një

¹⁸ Misha Glenny, *Historia e Ballkanit (1804-1999)*, Tiranë: Toena, 2007, f. 84.

¹⁹ N. Rich, *Diplomacia e Fuqive të Mëdha (1814-1914)*..., f.119.

²⁰ M. Glenny, *Historia e Ballkanit*..., f. 85.

numër i madh konservatorësh, vendosën ta shfrytëzojnë këtë situatë në të mirë të bashkimit. Për këtë, ata morën përkrahje të madhe nga Napoleoni III*, i cili e mbështeti programin maksimalist të rumunëve për bashkimin e dy principatave nën qeverisjen e një princi të huaj.²¹

Piemonti, i cili mezi priste të fitonte emrin e një fuqie të madhe në embrion, u dha rumunëve përkrahje të plotë, sepse e dinte mirë se një Rumani e bashkuar, do të krijonte një tjetër problem sigurie në një rajon të Perandorisë Habsburge, shumë larg Italisë. Franc Jozefi trembej se mos ky bashkim do të ushtronte një forcë tërheqëse të fuqishme për popullsinë e madhe rumune të Transilvanisë, prandaj, së bashku me Portën e Lartë, ai i kundërshtoi të gjitha orvatjet për zgjerimin e autonomisë së Principatave. Vjena dhe Kostandinopoja morën mbështetje nga Londra, e cila e shihte bashkimin si një rrezik për Perandorinë Osmane, statusin e lëkundur të së cilës, Britania, në fund të fundit, e kishte mbrojtur gjatë Luftës së Krimesë²².

Në maj të vitit 1858, përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha u takuan në Paris për të diskutuar çështjen rumune. Si edhe me parë, Franca ishte për bashkimin, kurse Perandoria Habsburge dhe Porta e Lartë qenë kundërshtarët kryesorë. Përsëri u arrit një kompromis i cili u përputh me Konventën e 19 gushtit 1858. Ky dokument që tani zëvendësoi Statutet Organike, sanksiononte një organizëm të ri politik për principatat. Provincat e Moldavisë dhe Vllahisë arritën sukses më 1859, kur zgjodhën një princ të vetëm, Aleksandër Kuza²³. A. Kuza* ishte një reformator dhe pjesëmarrës në Revolucionin e vitit 1848 në Bukuresht. Principatat do të quheshin Principatat e Bashkuara të Moldavisë dhe Vllahisë, do të mbeteshin në varësinë e sulltanit dhe të garantoheshin nga Fuqitë e Mëdha.

Lufta e Krimesë e viteve 1853-1856 e prishi unitetin e shteteve konservatore – Austrisë, Prusisë dhe Rusisë - që kishte qenë një nga dy shtyllat kryesore të rendit ndërkombëtar të Vjenës. Ky kombinim kishte

* Napoleoni III, gjatë jetës së tij e quajtën “*Sfinski i Tylereve*”, sepse ai kujtonte se bënte plane të mëdha dhe të shkëlqyera, të cilat asnjëri nuk mund t’i kujtonte, derisa gradualisht të zbuloheshin. H. Kissinger, *Diplomacia...*, f. 105.

²¹ M. Glenny, *Historia e Ballkanit...*, f. 65.

²² *Po aty*.

²³ *Po aty*.

* Aleksandër Kuza, ishte oficer nga Moldavia. Ka sunduar dy principatat e Moldavisë dhe të Vllahisë.

mbrojtur institucionet ekzistuese gjatë revolucioneve, kishte izoluar Francën, prishësen e mëparshme të paqes.²⁴

Rezultati më i qëndrueshëm i Luftës së Krimesë ishte shkatërrimi i bashkësisë evropiane. E mundur dhe e poshtëruar, Rusia ishte e vendosur të shkelte kufizimet e imponuara nga Traktati i Parisit, dhe u bë kështu një shtet revizionues. Por ajo u përmbajt nga ndërhyrja aktive në çështjen evropiane gjatë dy dekadave të mëvonshme, pasi po vendoste rregullin brenda vendit. Lufta e Krimesë ishte një konflikt ndërmjet Rosisë dhe Perandorisë Osmane e cila u mbështet nga Britania dhe Franca dhe së fundi u mbështet edhe nga shteti i Piemont-Sardenjës i Italisë së Veriut²⁵.

Britania, e zhgënjyer nga një luftë jo e lavdishme dhe nga një paqe e papërfunduar, u përqendrua në problemet e brendshme dhe u tërhoq shumë nga çështjet evropiane. Austria u izolua. Gjatë Luftës së Krimesë të dyja palët kishin parashikuar me besim mbështetjen e Austrisë: Rusia kishte pritur që Austria të mbështeste marrëveshjen e paqes të vitit 1815 kundër Francës dhe të paguante borxhin e mirënjohjes për ndihmën e fundit ushtarake dhe diplomatike. Britania dhe Franca kishin qenë të sigurt se Austria do të njihte domosdoshmërinë e ndalimit të ekspansionit rus në Evropën Juglindore, ku ishin në lojë interesat jetësore austriake. Asnjëherë Austria e Austrisë i armiqësoi të gjitha palët, duke bërë që, deri më 1879, Austria të ishte pa miq ndërmjet Fuqive të Mëdha.

Krizën e shkaktuar nga Lufta Ruso-Osmane, Vjena e shfrytëzoi, ndër të tjera, edhe për t'i shkëputur Portës së Lartë një varg koncesionesh dhe për të përforcuar pozitën e saj. Në Shqipërinë e Veriut, në bazë të traktateve ndërkombëtare, ajo kishte fituar të drejtën e mbrojtjes së popullsisë katolike (i ashtuquajtur *kultusprotektorat* - protektorat fetar).

Me ndërhyrjen e Austrisë, arriti të kthehej përsëri në Shkodër Urdhri i Jezuitëve, i dëbuar prej andej 11 vjet më parë. Me anë të një demonstrate detare përpara grykës së Bunës, më 1853, Vjena e detyroi Portën për ngritjen e një seminari të Jezuitëve. Disa vjet më vonë, u themelua në Shkodër nën mbrojtjen e Austrisë edhe një kuvend françeskan. Nga ana tjetër, kapitali tregtar austriak po përhapej në Shqipëri dhe në trevat e tjera perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Me forcimin e pozitave ekonomike dhe politike Austria fitoi në Shqipëri dhe

²⁴ Henry Kissinger, *Rendi botëror. Reflektime mbi karakterin kombeve dhe kursin e historisë*, AIIS, Tiranë: 2015, f. 72.

²⁵ N. Rich, *Diplomacia e Fuqive të Mëdha (1814-1914)*..., f. 101.

në Ballkanin Perëndimor një pozitë të privilegjuar ndër Fuqitë e Mëdha evropiane²⁶. Lufta e Krimesë ishte e panevojshme sepse, përpjekjet për të ruajtur apo vendosur paqen nëpërmjet bisedimeve dështuan²⁷. Qëllimi i kësaj lufte për të penguar zgjerimin e Ruisë nuk u arrit.

²⁶ Aleks Buda, *Shkrime Historike*, 2, Rilindja Kombëtare Shqiptare, Tiranë: 8 Nëntori, 1986, f. 38.

²⁷ N. Rich, *Diplomacia e Fuqive të Mëdha (1814-1914)*..., f. 101.